



***Task Force* si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës**

sipas Protokollit Opcional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjërëzore dhe Poshtëruese (OPCAT)



**RAPORT NGA MONITORIMI I QENDRËS KORREKTUESE NË DUBRAVË,
QENDRËS KORREKTUESE NË LIPJAN (FEMRA DHE TË MITUR) DHE
QENDRËS SË PARABURGIMIT NË LIPJAN**

Lista e shkurtesave	2
1. HYRJA.....	3
2. METODOLOGJIA.....	4
3. BAZA LIGJORE.....	5
3.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.....	5
3.2. Ligji i Avokatit të Popullit	5
3.3. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale	6
3.4. Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare	6
3.4.1. Konventa e KB kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese	6
3.4.2. Protokolli Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (OPCAT)	7
3.4.3. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore.....	8
3.4.4. Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (KPT).....	8
3.4.5. Disa nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.....	8
4. VENDIMET E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	10

Lista e shkurtesave

IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
OPCAT	Protokolli Opsional i Konventës së OKB kundër Torturës dhe formave të tjera të Keqtrajtimit, Trajtimit Çnjerëzor, Degradues dhe Ndëshkimit
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
SMR	Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të burgosurve
LESP	Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
QKD	Qendra Korrektuese në Dubravë
QKL	Qendra Korrektuese në Lipjan (për femra dhe të mitur)
QPL	Qendra e Paraburgimit në Lipjan
UNCAT	Konventa kundër Torturës dhe formave të tjera të Keqtrajtimit, trajtimit Çnjerëzor, Degradues dhe Ndëshkimit
KPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
MKP	Mekanizmi Kombëtar Parandalues
KKM	Komiteti i Këshillit të Ministrave

1. HYRJA

Protokolli shtesë i Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Torturës (OPCAT), ndër të tjera parashih krijimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT - NPM) përmes të cilit synohet realizimi i vizitave të rregullta në të gjitha ambientet e institucioneve publike ku liria e individit është e kufizuar. Bazuar në këto instrumente ndërkombëtare, institucionet e tilla si burgjet, qendrat e paraburgimit, stacionet e policisë, spitalet psikiatrike etj, do të jenë objekt i përhershëm inspektimi, me qëllim të respektimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve të trajtimit të individëve në këto ambiente.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke qenë një institucion i pavarur dhe duke pasur kompetenca të plota ligjore për të inspektuar dhe pasur qasje në institucionet ku mbahen personat e ndaluar, në bashkëpunim edhe me shoqërinë civile, ka formuar një grup të përbashkët (*Task Force_ Grupi Drejtues*), i cili në njëfarë forme do të kryejë obligimet që dalin nga OPCAT, si dhe do të llojë në krijimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës) MKPT në Kosovë.

Më 10 maj 2011, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKMRT) dhe Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) për krijimin e grupit punues të quajtur – *Grupi Drejtues*, e cila udhëhiqet nga palët nënshkruese sipas parimit të rotacionit. Nga janari 2013 e deri në qershor 2013, IAP ka udhëhequr *Grupi Drejtues*, zhvillon aktivitete, ndërmer veprime dhe lobon në drejtim të krijimit të një strukture kombëtare për parandalimin e torturës (MKP).

2. METODOLOGJIA

Programi monitorues i *Grupi Drejtues* përmban vlerësimin e vendeve të ndalimit që duhet vizituar, bazuar në informacionet në dispozicion. Mandati udhëheqës i *Task Force* obligon IAP, QKRMT dhe KMDLNJ të prezantojnë planet dhe listën e vendeve që planifikohen të vizitohen, bazuar në një vlerësim të rreziqeve potenciale për shkelje të drejtave të personave të ndaluar.

Monitorimi i vendeve të ndalimit në Kosovë është rregulluar nga legjislacioni vendor dhe standardet ndërkombëtare.

Në kuadër të realizimit të obligimeve ligjore, *Grupi Drejtues* ka realizuar monitorimin e Qendrës Korrektuese të Dubravës, Qendrës Korrektuese në Lipjan dhe Qendrës së Paraburgimit në Lipjan. Ky monitorim është zhvilluar në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës Kundër Torturës (OPCAT), Standardeve të Konventës Evropiane kundër Torturës dhe Rregullave Minimale të Standardeve të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Ndaluarve, si dhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP).

Monitorimi është zhvilluar nga 12 (dymbëdhjetë) përfaqësues (6 nga IAP, 3 nga QKRMT dhe 3 nga KMDLNJ), që ka përfshirë kombinim të profileve profesionale, në veçanti në fushën e drejtësisë dhe shëndetit publik dhe duke respektuar balancën gjinore.

Duke pasur parasysh se monitorimi i vendeve të ndalimit është një detyrë e ndjeshme dhe e vështirë, *Grupi Drejtues*, fillimisht ka zhvilluar takim të përbashkët, duke vlerësuar informatat e siguruara gjatë vizitave të mëhershme ose nga burimet e tjera (media, familjarët, avokatët etj.) dhe duke përcaktuar dhe ndarë detyrat për zhvillimin e monitorimit.

Monitorimi ka filluar, duke u takuar me drejtorin e QKD (Qendra Korrektuese në Dubravë) dhe pastaj edhe me drejtorin e QKL (Qendrës Korrektuese në Lipjan) dhe QPL (Qendrës së Paraburgimit në Lipjan), të cilët janë njoftuar me përbërjen e *Grupi Drejtues*, me kuptimin dhe qëllimin e vizitës, të metodave të punës si dhe qëllimin e përdorimit të informacioneve të mbledhura. Pastaj, janë zhvilluar vizitat në hapësirat ku janë të vendosur personat e ndaluar si dhe hapësirat në të cilat qëndrojnë dhe punojnë zyrtarët e burgut.

Gjatë vizitës janë vlerësuar kushtet në dhoma, aspektet problematike të këtyre kushteve dhe shkaqet (si p.sh. mbipopullimi, ushqimi, uji, ngrohja, shërbimi shëndetësor), incidentet e dhunës, vdekjet, grevat ose raste të tjera emergjente, përdorimi i masave disiplinore, kanë kërkuar informata lidhur me të ndaluarit me nevoja të veçanta (gratë, të miturit, të sëmuret, personat me aftësi të kufizuara apo të sëmuret mendor), për marrëdhëniet ndërmjet të burgosurve në njëri anë dhe të burgosurve me stafin, në anën tjetër, si dhe janë intervistuar të ndaluar.

Anëtarët e *Grupi Drejtues*, gjatë procesit të monitorimit kanë bashkëpunuar me drejtorët, stafin e burgut dhe personelin, si dhe kanë respektuar rregullat dhe rregulloret e sigurisë. Me këtë rast dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për bashkëpunimin e treguar.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës¹

Kapitulli II Të Drejtat dhe Liritë Themelore

“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.” (neni 21)

“Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.” (neni 27)

1. “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.
2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.
3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.” (neni 132)

3.2. Ligji i Avokatit të Popullit²

7. “Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të lëvizjes së kufizuar dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet.”

8. “Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund të hyjnë në hapësirat zyrtare të të gjitha organeve të autoriteteve publike, organeve tjera dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.” (neni 16)

1. “Të gjitha organet e pushtetit shtetëror kanë për obligim ta ndihmojnë Avokatin e Popullit në zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.”

2. “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit, nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.” (neni 23)

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-195.

3.3. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale³

“ Ekzekutimi i sanksioneve penale ka për qëllim risocializimin dhe riintegrimin e të denuarit në shoqëri dhe përgatitjen e tij për jetë dhe sjellje të përgjegjshme.”[....] (neni 4)

1. “Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrën e cila siguron trajtimin human dhe respektimin e dinjitetit të secilit individ. Personi i dënuar nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor a degradues.”(neni 5)

2. “Gjatë vendosjes së personit të dënuar në institucionin korrektues ose në njësi të veçantë të institucionit korrektues duhet të merret parasysh moshë e tij, llojet dhe pesha e dënimit, fakti se a ka qenë më parë i dënuar, shëndeti i tij fizik dhe mendor, kërkesat për trajtim të veçantë, lokacioni i vendbanimit ose vendqëndrimit të familjes së tij, siguria e tij si dhe arsyet lidhur me arsimimin ose punën që mund të jenë të rëndësishme për riintegrimin e tij shoqëror. [...]

3. Personat e dënuar meshkuj dhe femra vendosen ndarazi.[...]

4. Personat madhorë nuk vendosen në institucionin korrektues ose në një pjesë të institucionit korrektues me të miturit.

5. Personat e dënuar nuk vendosen në të njëjtën pjesë të institucionit me personat e paraburgosur.

6. Ministria e Drejtësisë nxjerrë urdhëresë lidhur me vendosjen e personave të dënuar të moshave specifike, të kategorive shëndetësore ose të kategorive që e rrezikojnë sigurinë.” (neni 33)

1. “ Personi i dënuar ka të drejtë në vendosje që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.”

2. Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra kub hapësirë dhe kur është e mundur katër (4) metra katrorë për të burgosurit në qeli të përbashkëta dhe nëntë (9) katrorë për të burgosurit në qeli të vetme dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.” [...] (neni 36)

3.4. Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare

3.4.1. Konventa e KB kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese

“1. Çdo shtet palë merr masa efektive legjislative, administrative, gjyqësore ose masa të tjera për të parandaluar veprimet e torturës në cilindo territor nën juridiksionin e tij.

“2. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcenim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.”

“3. Urdhri i dhënë nga një epror ose autoritet publik nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.” (neni 2)

³ Ligji Nr.03/L-191.

3.4.2. Protokoll i Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (OPCAT)

“Qëllimi i këtij protokoll është që të vendos sistem të vizitave të rregullta vendeve ku gjenden personat e privuar nga liria nga organet e pavarura ndërkombëtare dhe vendore, për parandalimin e torturës dhe dënimeve e veprimeve tjera mizore, çnjërëzore apo degraduese” (neni 1).

“1. Shtetet anëtare janë të obliguara që të garantojnë pavarësinë funksionale të mekanizmave kombëtar të parandalimit, si dhe pavarësinë e personelit të tyre.

2. Shtetet anëtare janë të obliguara të ndërmarrin masat e domosdoshme që personeli profesional i mekanizmave kombëtar të ketë aftësi të nevojshme dhe njohuri profesionale.

Janë të obliguar që të sigurojnë baraspeshë ndërmjet gjinive, si dhe përfaqësimin adekuat të grupeve etnike dhe pakicave në vend.

3. Shtetet anëtare obligohen që të venë në dispozicion mjetet e domosdoshme për funksionimin e mekanizmave kombëtar të parandalimit.

4. Me rastin e krijimit të mekanizmave kombëtar të parandalimit, shtetet anëtare janë të obliguara që të marrin parasysh parimet që kanë të bëjnë me statusin dhe funksionimin e institucioneve kombëtare për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut “(neni 18)

“Mekanizmat kombëtar të parandalimit duhet t’i kenë patjetër këto autorizime:

(a) Që rregullisht të kontrollojnë trajtimin e personave të privuar nga liria në institucionet e paraburgimit, siç është definuar në nenin 4. me qëllim që, nëse duhet, të shtohet mbrojtja e tyre nga tortura, dënimi dhe veprimet mizore, çnjërëzore apo degraduese.

(b) Që t’u japin rekomandime organeve kompetente me qëllim të përmirësimit të trajtimit dhe pozitës së personave të privuar nga liria dhe që të pengohet tortura dhe veprimet e dënimi mizor, çnjërëzor apo degradues, duke marrë parasysh normat relevante të Kombeve të bashkuara.

(c) Që të japin propozime dhe mendime lidhur me ligjet në fuqi apo ligjet e propozuara” (neni 19).

“ Mekanizmat kombëtar të parandalimit, për të kryer autorizimet e veta, shtetet anëtare të këtij protokoll obligohen të sigurojnë:

(a) Qasje të të gjitha të dhënave për numrin e personave të privuar nga liria në institucionet e paraburgimit, e definuar në nenin 4, si dhe numrin e institucioneve dhe lokacionin e tyre;

(b) Qasje në të gjitha shënimet për trajtimin e këtyre personave dhe kushtet e paraburgimit të tyre;

(c) Qasje të të gjitha institucioneve të paraburgimit, instalimeve dhe objekteve të tyre.

(d) Mundësia që të zhvillojnë biseda private me personat e privuar nga liria, pa prani të dëshmitarëve, personalisht apo me përkthyes nëse është e nevojshme, apo me cilindo person tjetër, për të cilin mekanizmi kombëtar i parandalimit konsideron se mund të ofroj informata të rëndësishme;

(e) Liri që të zgjedhin vendet që duan t’i vizitojnë dhe me të cilët duan të bisedojnë;

(f) Të drejtën që të kenë kontakte me Nën Komitetin për parandalim, që t’i dërgojnë shënime dhe të takohen me te.” (neni 20)

“Institucionet shtetërore të shtetit anëtar janë të obliguara që të shqyrtojnë rekomandimet e mekanizmit kombëtar të parandalimit dhe të bëjnë dialog me të lidhur me masat e mundshme të implementimit”. (neni 22)

3.4.3. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet veprimit apo dënimit torturues apo trajtimit çnjerëzor apo degradues”. (neni 3)

3.4.4. Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Më të Rënda, Çnjerëzore dhe Poshtëruese (KPT)

“Krijohet një Komitet evropian për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese (i quajtur tani e tutje *Komiteti*). Me anë të vizitave, Komiteti shqyrton trajtimin e personave të privuar nga liria duke synuar, në rast se nevojitet, forcimin e mbrojtjes së tyre kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.” (neni 1)

3.4.5. Disa nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

MKP kur viziton një burg, shqyrton shumë çështje, natyrisht duke i kushtuar vëmendje të veçantë çdo pretendimi për ushtrim të torturës. Sidoqoftë, të gjitha aspektet e kushteve të mbajtjes në burg janë shumë të rëndësishme për mandatin e MKP. Në vazhdim po theksojmë më hollësisht standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me kushtet materiale në qeli, higjienën, ushqimin dhe ujin, shërbimet mjekësore dhe regjimin adekuat të aktiviteteve, disiplinën, dënimin dhe ankesat.

a) Kushtet materiale në dhoma dhe dhoma izolimi

Komiteti për parandalimin e torturës ofron pasqyrë të dobishme të standardeve të pranueshme në dhoma izolimi dhe thekson se dhomat e izolimit në të cilat janë vendosur të paraburgosurit duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme jetësore, ndriçim të mirë natyral, ajrosje, ndriçim dhe nxehtë adeguate artificiale. Zgjidhjet sanitare duhet t’u mundësojnë të paraburgosurve që t’i kryejnë nevojat fiziologjike në kushte të pastra dhe komode, tualeti do të duhej të vendoset në dhomën e izolimit (sipas mundësisë në nyje të ndarë sanitare), apo duhet të ekzistojnë mundësitë që të ndaluarve të cilët duhet ta shfrytëzojnë tualetin, t’iu mundësohet, qasja pa shtyrje në çdo kohë të ditës e natës. Është e dëshirueshme që në dhomat izoluese të kenë qasje në ujë të pijshëm, ndërsa të ndaluarit duhet të kenë qasje përkatëse në banja. Dhoma izoluese duhet të jetë e pajisur në mënyrë përkatëse (krevat, tavolinë, karrige, vend për vendosjen e gjësendeve), të gjitha hapësirat dhe pajisja të jenë në gjendje të mirë, ndërsa të ndaluarit duhet ta mirëmbajnë akomodimin në gjendje të pastër përkatëse.⁴ Madhësia e hapësirave dhe numri i të paraburgosurve të vendosur janë problem serioz sepse mbi ngarkesa e burgjeve “nga aspekti fizik mund të jetë johuman dhe degradues”.⁵

⁴ Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti për Andorën, CPT/Inf(2000)11

⁵ Pjesë nga Raporti i 2-të I Përgjithshëm [CPT/Inf (92) 3]

Mbipopullimi në një burg ose pjesë të veçantë të tij, mund të jetë i tillë që të jetë në vetvete çnjerëzor ose poshtërues nga një pikëvështrim fizik.⁶ Nuk ka udhëzime të qarta rreth çështjes së madhësisë së dhomave izoluese, edhe pse Komiteti i Këshillit të Ministrave (KKM) ka caktuar disa udhëzime përmes raporteve të veta.

b) Higjiena

Të ndaluarit duhet të kenë mundësi që të bëjnë dush së paku dy herë në javë, nëse është e mundur edhe një herë në ditë.⁷ Drejtoria e burgut duhet të siguroj artikuj për tualet, si dhe mjete për pastrim, që do t'u mundësonte të ndaluarve të pastrojnë dhomat/dhomat e izolimit.⁸

Komiteti dëshiron gjithashtu të tërheqë vëmendjen lidhur me problemet e higjienës dhe të shëndetit të grave të privuar nga liria e tyre, nevojat higjienike të cilave janë të veçanta dhe ndryshojnë shumë nga ato të burrave.⁹

c) Ushqimi dhe uji

Të ndaluarit duhet të kenë të siguar tri shujta në ditë të shpërndarë në intervale të arsyeshme kohore.¹⁰

d) Shërbimet mjekësore- mbrojtja shëndetësore

Drejtoria e institucionit duhet “të mbroj shëndetin e të gjithë të burgosurve në burgun e vet”.¹¹ Sipas Rregullave Standarde Minimale të KB, paragrafi 22, çdo institucion ndëshkimor - përmirësues apo qendër paraburgimi duhet të ketë në dispozicion së paku një mjek të kualifikuar. Përveç kësaj, të paraburgosurit duhet të kenë qasje te psikiatri apo stomatologu. Sipas KKM, shërbimet adekuate shëndetësore mund të kenë “ ndikim pozitiv në kualitetin e tërësishëm të jetesës në kuadër të objekteve në të cilën ju ofrohen shërbimet”.

Për sa i përket grave të privuara nga liria, duhet respektuar parimin e ekuivalencës së mjekimeve, duke u mjekuar nga mjekë dhe infermiere me të njëjtin formim shëndetësor në çështjet e shëndetit specifik për gratë, përfshirë këtu gjinekologjinë.¹²

e) Regjimi përkatës i aktiviteteve

Një program i kënaqshëm aktiviteteve (punë, edukim, sport, etj.) është më rëndësi kryesore për mirëqenien e të burgosurve. Kjo është e vërtetë për të gjitha institucionet, si për të burgosurit e dënuar ashtu edhe për ata që presin gjykimin. Sidoqoftë, të ndaluarit nuk mund të lihen të vuajnë për javë, e ndoshta muaj, të mbyllur në qeli, pavarësisht se sa të mira mund të jenë kushtet materiale në qeli.¹³

⁶ Pjesë nga Raporti i 2-të i Përgjithshëm [CPT/Inf(92)3]

⁷ Rregullat Evropiane të burgjeve, paragrafi 19.4

⁸ Po aty, 19.6

⁹ Pjesë nga Raporti I 10-të i përgjithshëm [CPT/inf(2000)13]

¹⁰ Rregullat Evropiane të burgjeve, paragrafi 22.4

¹¹ Po aty, paragrafi 39

¹² Pjesë nga Raporti i 10-të i përgjithshëm [CPT/Inf (2000) 13]

¹³ Pjesë nga raporti i 2-të i përgjithshëm [CPT/Inf(92) 3]

Drejtoria e institucionit po ashtu duhet të siguroj aktivitete të mjaftueshme rekreative, duke përfshirë sportin, lojërat, aktivitetet kulturore dhe aktivitetet e tjera rekreative. Ndonëse, mungesa e aktivitetit të qëllimshëm është e dëmshme për çdo të burgosur, ajo është veçanërisht kështu për të miturit, të cilët kanë nevojë të veçantë për aktivitet fizik dhe stimulim intelektual. Të miturve në heqje lirie duhet t'u ofrohet një program i plotë arsimit, sporti, trajnimi profesional, rikrijimi dhe aktivitetesh të tjera të qëllimshme. Edukimi fizik duhet të përbëjë një pjesë të rëndësishme të atij programi.¹⁴ Të burgosurve duhet lejuar të kenë kontakte me botën e jashtme, përkatësisht të kenë mundësi të komunikojnë me familjet dhe miqtë e tyre. Rregullat evropiane të burgjeve, paragrafi 24.4, përcaktojnë që të burgosurve, “duhet lejuar mbajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve familjare në mënyrë normale, sa më shumë që mundet”. Të burgosurve do duhej lejuar që të jenë të informuar për punët publike duke lexuar gazeta dhe publikime tjera, duke dëgjuar radio dhe shikuar televizion.

f) Masat disiplinore

Sipas Rregullave Standarde Minimale të KB-së, paragrafi 27, “disiplina dhe rendi duhet të mbahen me vendosmëri, por pa kufizime të tepruara, përveç asaj të nevojshme për ruajtje të sigurt dhe jetë të rregulluar mirë në bashkësi.”

Institucionet duhet të kenë të vendosura procedurat disiplinore të cilat të paraburgosurve dhe të burgosurve u mundësojnë të drejtën që të jenë të informuar për kundërvajtjet e supozuara, që të mbrohen dhe të ankohen në instancë më të lartë kundër të gjitha sanksioneve të shqiptuara. Rregullat Standarde Minimale të KB-së, paragrafi 31 dhe Rregullat Evropiane të Burgjeve, paragrafi 60.3, ndalojnë dënimet kolektive dhe dënimet trupore, dënimin me qëndrim në qeli të errët, si dhe të gjitha format e tjera të dënimit johuman dhe degradues.

KPT në raportet e saj thekson rëndësinë e madhe që i kushton trajnimit të personelit të zbatimit të ligjit (shprehja “*personel* për zbatimin e ligjit” përfshin punonjësit e policisë edhe të burgut). Argumentohet se nuk ka garanci më të mirë kundër keqtrajtimit të një personi në heqje lirie se sa një punonjës i trajnuar siç duhet.

4. VENDIMET E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJNDNJ) ka nxjerrë një mori vendimesh për kushtet materiale në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit. GJEDNJ, ashtu edhe KKM kanë konstatuar se ekspozimi ndaj kushteve të këqija materiale mund të paraqes veprim çnjerëzor dhe degradues, përkatësisht shkelje të nenit 3 të KEDNJ.

Për shembull, në rastin *Peers kundër Greqisë*, GJEDNJ ka konstatuar që “burgosja e parashtruesit të ankesës në qeli të ngushtë pa ventilim dhe dritare, ku i është dashur të shfrytëzojë tualetin në prezencë të të burgosurit tjetër dhe të jetë prezent kur i burgosuri tjetër e ka shfrytëzuar tualetin, paraqesin veprim degradues.”¹⁵

¹⁴ Pjesë nga Raporti i 9-të i përgjithshëm [CPT/Inf (99)12]

¹⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Peers kundër Greqisë* Nr.28524/95, 19 prill 2001



Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë

Qendra Kosovare për Rehabilitim e të Mbijetuarve nga Tortura

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

Raport nga

Grupi Punues (*Task Force*) për Mekanizmin Kombëtar për Parandalim të Torturës (NPM)

Monitorimi i Qendrës Korrektuese në Dubravë, më 26 prill 2013

Monitorimi i Burgut të Dubravës është realizuar më 26 prill, nga *Task Force*, dhe nga të gjeturat, do të dalin rekomandimet të cilat do t'i përcillen Ministrisë së Drejtësisë, SHKK dhe Burgut të Dubravës.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve të *Task Force* në monitorim ishte 12 dhe atë 6 përfaqësues nga IAP, 3 nga KMDL NJ dhe 3 nga QKRMT. *Task Force* fillimisht më 26 prill 2013 mbajti një takim,¹ në të cilin u bë ndarja e ekipeve monitoruese dhe përcaktimi i pavijoneve që do të monitoroheshin. Ndarja dhe përbërja e ekipeve ishte si në vijim:

Ekipi A: Shqipe Ibraj-Mala, zëvendëse e Avokatit të Popullit – IAP; Behxhet Sh. Shala, Drejtor Ekzekutiv – KMDL NJ; Reshat Bajrami, mjek-monitorues - QKRMT dhe Fitnete Mala, këshilltare ligjore - IAP.

Ekipi B: Faton Morina, këshilltar i lartë ligjor – IAP; Alban Muriqi, menaxher i projektit (monitorues) – QKRMT; Tringa Shehu, koordinatore e projektit - KMDL NJ dhe Fatmire Rexhaj, këshilltare ligjore - IAP.

Ekipi C: Arber Berisha, këshilltar ligjor – IAP; Fatmire Haliti, menaxhere e projektit (monitoruese) – QKRMT; Valentina Demolli, hulumtuese terreni – KMDL NJ; Shemsedin Mustafa, këshilltar ligjor - IAP.

¹ Takimi u realizua në afërsi të QK të Dubravës, KK Istog.

Takimi me drejtorin e QK në Dubravë:

Task Force fillimisht u takua me drejtorin e Qendrës Korrektuese në Dubravë (QKD), z. Rasim Selmani, të cilin e informuan për qëllimin e kësaj vizite. Drejtori Selmani e informoi Grupin Punues me gjendjen aktuale në këtë qendër korrektuese, duke theksuar se problemet në këtë qendër janë kryesisht të natyrës teknike (rinovimi i disa pavijoneve, mungesa e dyshekëve të përshtatshëm dhe çarçafëve etj.) ndërkaq, sa i përket çështjes së sigurisë deklaroi se nuk ka probleme dhe se këtë gjendje e vlerësoi si stabile. Mirëpo, pamundësia për sistemimin e personave të privuar nga liria në bazë të natyrës së veprës dhe dënimit si dhe centralizimi i financimit po ua vështirëson punën në këtë qendër, duke shpresuar se pas fillimit të punës së Burgut të Sigurisë së Lartë në Gërdofc shumë gjëra do të stabilizohen në QKD. Këtë vizitë të *Task Force* drejtori i QKD e vlerësoi si shumë të dobishme dhe ndihmë për institucionin korrektues që e drejton, shkak se problemet e identifikuar dhe rekomandimet e *Task Force* do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve për personat e privuar nga liria, trajtimin e tyre por edhe në vet punën e stafit korrektues. Drejtori Selmani u tregua shumë bashkëpunues, duke ua krijuar të gjitha kushtet për një monitorim të papenguar dhe gjithëpërfshirës. Pas vizitës monitoruese,

Vizita në pavijonin nr.1:

Vizita e Ekipit B në këtë pavijon filloi me një takim të shkurtër me mbikëqyrësin e pavijonit z. Rifat Kabashi, i cili u informua me qëllimin e vizitës dhe nga ana e tij u siguruan këto informata të përgjithshme.

Gjithsej 106 persona të privuar nga liria, ndërsa kapaciteti është 116.

Në pavijon janë të vendosura dy kuti të ankesave dhe shtypi ditor ofrohet vetëm me pagesë. Kategorizimi në këtë pavijon nuk është i duhur dhe nuk është në përputhje me natyrën e veprave dhe kohëzgjatjen e dënimeve, ndërsa angazhimi i të dënuarve në punë nuk ofrohet.

Pas përfundimit të takimit me z. Kabashi ekipi vazhdon vizitën nëpër hapësirat e pavijonit ku edhe vëren këtë gjendje:

▪ **Infrastruktura**

- Numri i personave të vendosura në disa dhoma shkon deri në 6 dhe ka dëshmi për mbipopullim.

▪ **Higjiena**

- Banjat dhe tualetet janë të përbashkëta për secilin krah, por pastërtia e tyre nuk është në nivel të duhur;
- Mungesë të ujit të ngrohtë.

▪ **Shëndetësia**

- Mungesë e theksuar e vizitave të rregullta mjekësore;
- Vonesa të tejzgjatura në ofrimin e shërbimeve mjekësore;
- Mungesë me furnizimit adekuat me barna në raste të caktuara;

- Mungesë të ofrimit të shërbimeve dentare.
- **Trajtimi**
- Ankesa për sjellje të dhunshme nga stafi, kishte pohime për përdorim të forcës dhe ofendime (përmenden emrat e dy oficerëve);
- Ankesa për privilegje dhe benificione mbi bazat e nepotizmit dhe lokalizmit;
- Ankesa për qëndrime të gjata në këtë pavijon i cili nuk e ka një destinim të tillë;
- Ankesa të theksuara sa i përket trajtimit dhe kontrolleve të familjarëve gjatë vizitave veçanërisht ndaj femrave.
- **Ushqimi**
- Pakënaqësi të shumta në cilësinë e ushqimit;
- Ankesa për mënyrën e ofrimit të ushqimit (koha dhe vendi jo adekuat).
- **Informimi**
- Nuk janë të informuar me të drejtat e garantuara;
- Trajtimi i ankesave të drejtuara nga të dënuarit nuk ka një procedurë të qartë dhe ka vonesa në shqyrtimin e tyre.

Vizita në pavijonin nr. 2:

Vizita e Ekipit C në këtë pavijon filloi me një takim të shkurtër me mbikëqyrësin e pavijonit z. Muhamet Aliu dhe me udhëheqësin e pavijonit Nuhi Etemaj, të cilët u informuan me qëllimin e vizitës dhe u nga ana e tyre u siguruan këto informata të përgjithshme.

Gjithsejtë të pranishëm 169 persona ndërsa kapacitetit i përgjithshëm 170. Në këtë pavijon mbahen personat e paraburgosur dhe dy me rrezikshmëri të lartë.

Pas përfundimit të takimit me udhëheqësit e këtij pavijoni ekipi vazhdon vizitën nëpër hapësirat e pavijonit ku edhe vëren këtë gjendje:

- **Infrastruktura**
- Ajrosja e dhomave jo adekuate në këtë pavijon për shkak të numrit të madh të personave në një dhomë (6 persona në një dhomë)
- Ndriçimi natyror i mjaftueshëm ndërsa sa i përket sistemit elektrik është jo i duhur dhe paraqet rrezik për personat.
- **Higjiena**
- Banjat dhe tualetet janë të përbashkëta për secilin krah por pastërtia e tyre nuk është në nivel të duhur;
- Mungesë të ujit të ngrohtë;
- Mungon inventari adekuat për rroba.
- **Shëndetësia**

- Vonesa në ofrimin e shërbimeve mjekësore në raste kur ka kërkesa për trajtim;
- Terapi jo adekuate të barnave dhe administrim jo i duhur (pohime për nepotizëm)
- **Trajtimi**
- Trajtim korrekt nga zyrtaret korrektues;
- Aktivitete të kufizuara fizike për shkak të kategorisë (të paraburgosur);
- Stërzgjatje e paraburgimit 4 deri në 5 vite në paraburgim (kishte një rast ku personi me çrregullime psikiatrike mbahet që 4 vite);
- Vizitat dhe telefonatat ofrohen në përputhje me statusin e tyre.
- **Ushqimi**
- Ushqimi jo cilësor;
- Mënyra e ofrimit, vendi dhe koha jo e rregullt (darka ofrohet në ora 15:00).
- **Informimi**
- Nuk janë të informuar me të drejtat e garantuara;
- Trajtimi i ankesave të drejtuara nga të dënuarit nuk ka një procedurë të qartë dhe ka vonesa në shqyrtimin e tyre.

Vizita në pavijonin nr. 3:

Vizita e Ekipit C në këtë pavijon filloi me një takim të shkurtër me mbikëqyrësin e lartë të pavijonit z. Ferat Ferati, i cili u informua me qëllimin e vizitës dhe nga ana e tij u siguruan këto informata të përgjithshme.

Gjendja aktualë 80 persona ndërsa kapaciteti 84. Për momentin në këtë pavijon funksionojnë dy krah ndërsa krahët tjerë janë në renovim dhe të burgosurit që kanë qenë në këto hapësira janë vendosur në pavijone tjera dhe në qendra tjera korrektuese varësisht prej llojit të dënimeve. Ky pavijon është i dedikuar për të burgosur të regjimit standard (për dënime nga 1 deri mbi 30 vite).

Pas përfundimit të takimit me udhëheqësit e këtij pavijoni ekipi vazhdon vizitën nëpër hapësirat e pavijonit ku edhe vëren këtë gjendje:

- **Infrastruktura**
- Ndriçimi dhe ajrosja në dhoma, salla dhe hapësirat e pavijonit ishte në rregull;
- Numri i personave të vendosur brenda kapaciteteve;
- Muret e dhomave janë të dëmtuara dhe ka lagështi të madhe si pasojë e rrjedhjeve të njejtve sanitare.
- **Higjiena**
- Banjat të vendosura nëpër dhoma bashkë me tualete dhe gjendja e tyre është jashtë çdo standardi;
- Nuk ka ujë të ngrohtë rregullisht (dy herë në javë) dhe si pasojë e kësaj të dënuarit janë të detyruar të improvizojnë metoda të rrezikshme për ngrohjen e ujit;

- Ankesa në cilësinë e produkteve higjienike;
- Higjiena e dhomave dhe rrobave është e pamundur për shkak të problemeve me lagështi.
- **Shëndetësia**
- Probleme të theksuara, për arsye se ka persona që kanë qenë përdorues të substancave narkotike dhe kanë nevojë specifike për trajtim;
- Vonesa në ofrimin e shërbimeve, edhe në raste kur shërbimet mjekësore janë të domosdoshme.
- **Trajtimi**
- Në këtë pavijon nuk kishte ankesa sa i përket sjelljes së stafit;
- Raportet ndërmjet të dënuarve në nivel të duhur;
- Aktivitetet fizike dhe trajnimet janë në nivel të duhur;
- Ankesa të theksuara sa i përket trajtimit dhe kontrolleve të familjarëve gjatë vizitave veçanërisht ndaj femrave.
- **Ushqimi**
- Pakënaqësi të shumta në cilësinë e ushqimit;
- Ankesa për mënyrën e ofrimit të ushqimit (koha dhe vendi jo adekuat).
- **Informimi**
- Nuk janë të informuar me të drejtat e garantuara;
- Trajtimi i ankesave të drejtuara nga të dënuarit nuk ka një procedurë të çartë dhe ka vonesa në shqyrtimin e tyre.

Vizita në pavijonin nr. 5:

Vizita e Ekipit B, në këtë pavijon filloi me një takim të shkurtër me mbikëqyrësin e pavijonit z.Jeton Fetahaj, i cili u informua me qëllimin e vizitës dhe nga ana e tij u siguruan këto informata të përgjithshme.

Gjithsejtë 135 persona të privuar nga liria ndërsa kapaciteti maksimal i këtij pavijoni 156. Persona të cilat mbaheshin në vetmi 5 persona. Gjithsej 6 oficerë (për ndërrim) dhe një mbikëqyrës, si dhe 2 punëtorë socialë. Në pavijon janë të vendosura dy kuti të ankesave dhe shtypi ditor ofrohet vetëm me pagesë. Në pavijon ekzistojnë regjistrat për hyrje - dalje dhe çdo lëvizje e tyre evidentohet.

Sa i përket natyrës së veprave janë të ndryshme nga një muaj deri në 35 vite. Kategorizimi në këtë pavijon nuk është i duhur dhe angazhimi i të dënuarve në punë nuk ofrohet. Në pavijon momentalisht ka shtetas të huaj dhe çështja e përkthimit nuk ofrohet. Objekti është i ndërtuar para më shumë se 30 vite dhe renovimi (sanimi) i fundit është bërë para 3 vite, por ky renovim ka lënë shumë për të dëshiruar. Pas përfundimit të takimit me udhëheqësit e këtij pavijoni, ekipi vazhdon vizitën nëpër hapësirat e pavijonit, ku vërehet kjo gjendje:

- **Infrastruktura**

- Ndriçimi dhe ajrosja në dhoma, salla dhe hapësirat e pavijonit ishte në rregull;
- Numri i personave të vendosur brenda kapaciteteve;
- Muret e dhomave janë të dëmtuara dhe ka lagështi të madhe si pasojë e rrjedhjeve të nyejve sanitare.
- **Higjiena**
- Banjat të vendosura nëpër dhoma bashkë me tualete dhe gjendja e tyre është jashtë çdo standardi;
- Nuk ka ujë të ngrohtë rregullisht (dy herë në javë) dhe si pasojë e kësaj të dënuarit janë të detyruar të improvizojnë metoda të rrezikshme për ngrohjen e ujit;
- Ankesa në cilësinë e produkteve higjienike;
- Higjiena e dhomave dhe rrobave është e pamundur për shkak të problemeve me lagështi.
- **Shëndetësia**
- Mungesë e theksuar e vizitave të rregullta mjekësore;
- Vonesa të tej zgjatura në ofrimin e shërbimeve mjekësore;
- Kishte raste që personat në vetmi nuk ishin vizituar fare nga mjeku;
- Mungesë me furnizim adekuat me barna në raste të caktuara;
- Mungesë të ofrimit të shërbimeve dentare
- **Trajtimi**
- Në këtë pavijon nuk kishte ankesa sa i përket sjelljes së stafit;
- Raportet ndërmjet të dënuarve në nivel të duhur;
- Aktivitetet fizike dhe trajnimet janë në nivel të duhur;
- Ankesa të theksuara sa i përket trajtimit dhe kontrolleve të familjarëve gjatë vizitave veçanërisht ndaj femrave.
- **Ushqimi**
- Pakënaqësi të shumta në cilësinë e ushqimit;
- Ankesa për mënyrën e ofrimit të ushqimit (koha dhe vendi jo adekuat).
- **Informimi**
- Nuk janë të informuar me të drejtat e garantuara;
- Trajtimi i ankesave të drejtuara nga të dënuarit nuk ka një procedurë të qartë dhe ka vonesa në shqyrtimin e tyre.

Vizita në pavijonin nr. 7:

Vizita e Ekipit A në këtë pavijon filloi me takimin me mbikëqyrësin e pavijonit, z. Ismet Kovaçević, pastaj me vizitën nëpër hapësirat e pavijonit ku edhe vëren këtë gjendje: në këtë pavijon janë të vendosur 19 persona.

- **Infrastruktura**

- Gjendja e objektit është mjaftë e rëndë. Pikon tavani nëpër dhoma. Banjot janë të demtuara, nuk punojnë qeshmet. Uji rrjedh nga sholet. Muret janë të demtuara.

- **Higjiena**

- Nuk ka qarqaf dhe mbulesa për jastek që disa muaj.
- Higjiena e dhomave dhe rrobave është e pamundur për shkak të problemeve me lagështi.

- **Shëndetësia**

- Në pavionin e shtatë janë të vendosur të sëmuret kronik në krevate një katëshe.

- **Trajtimi**

- Në këtë pavijon nuk kishte ankesa sa i përket sjelljes së stafit;
- Raportet ndërmjet të dënuarve në nivel të duhur;
- Aktivitetet fizike dhe trajnimet janë në nivel të duhur;
- Ankesa të theksuara sa i përket trajtimit dhe kontrolleve të familjarëve gjatë vizitave veçanërisht ndaj femrave.

- **Ushqimi**

- Pakënaqësi të shumta në cilësinë e ushqimit;
- Nuk respektohen dietat mjekesore.

- **Informimi**

- Nuk janë të informuar me të drejtat e garantuara;
- Trajtimi i ankesave të drejtuara nga të dënuarit nuk ka një procedurë të qartë dhe ka vonesa në shqyrtimin e tyre.

- **Intervistat**

- Në këtë pavion janë bërë disa intervista me të sëmurë.
- Ankesat ishin nga më të ndryshmet: ankesa për punën e mjekëve, për lirim me kusht, për transfere dhe për kushtet e vështira për jetesë në këtë pavijon.

Vizita në Spitalin e QK në Dubravë:

Vizita e Ekipit A në Spital filloi me një takim me mjekun kujdestar: Dr. Fidan Berisha, kryeteknikun – Hamzë Fekaj, psikologun - Granit Shatri, të cilët u informuan me qëllimin e vizitës dhe u informuan për gjendjen e përgjithshme, po ashtu u vizituan edhe hapësirat e këtij pavijoni dhe farmacia e këtij spitali.

- Stafit përbëhet prej: 6 mjekëve, 28 teknikeve, një psikolog që është i angazhuar edhe për Qendrën e Paraburgimit në Pejë. Gjatë ditës punojnë dy mjek dhe gjashtë teknik, laboranti, tekniku i farmacisë ndërsa natën një mjek dhe dy teknik.

- Shërbimi Korrektues është i përfshirë në strategjinë kombëtare për adresimin e TBC, HIV Aids dhe sëmundje të tjera ngjithëse. Janë zbuluar tetë raste me TBC, janë izoluar dhe janë nën terapi nga mjeku specialist. Janë marrë sputumet dhe është vërejtur se të sëmurit janë në përmirësim e sipër.
- Qasja te mjeku i burgut është e shpejtë, brenda ditës ose të nesërmen ndërsa në shërbimet jashtë spitalit, varet nga natyra e sëmundjes dhe nga mundësia absorbuese ne QKUK - rasti paralajmërohet me pare dhe sipas radhës, me përjashtim te rasteve urgjente.
- Kushtet fizike në spitalin e Dubravës janë të rënda për punë. Objekti është i dëmtuar mjaftë, në disa hapësira pikon tavani (në dhomën e teknikeve, kati përdhese, në dhomën e arkivit, në katin e dytë, në dhomën e kryeshefit mjekësor), ka lagështi, muret janë të dëmtuara.
- Ekzistojnë rregulla për evakuim mjekësor emergjent - Qasja te psikologu është se paku njëherë ose edhe më shumë, sipas nevojës. Por, është shume e vështirë sepse është i angazhuar vetëm një psikolog, i cili punon edhe ne Qendrën e Paraburgimit në Pejë. Nuk ka udhëzues për përdorimin e testeve psikologjike.
- Depoja për barna është adekuate, barnat porositen në bazë të nevojës, dy herë në vit, për rezervat, përgjegjës është tekniku i farmacisë. Barnat e skaduara veçohen dhe merret Ministria e Shëndetësisë me asgjësimin e tyre.
- Gjatë këtij viti, ka pasur edhe te burgosur të pranuar me sëmundje mendore dhe për ta kujdeset psikiatri. Për momentin, këta te burgosur trajtohen vetëm me barna dhe nuk ka aktivitete te tjera rehabilituese.
- Vetmia - i dënuari në vetmi ekzaminohet nga mjeku para izolimit, ka vizita te rregullta çdo ditë dhe vizita shtesë sipas nevojës. Nuk ka ndonjë evidencë se te ndonjë grup minoritar është aplikuar me shpesh vetmia.
- Spitali është i organizuar në disa shërbime specialistike: Shërbimi i Kirurgjisë se vogël, Ortopedisë, Kardiologjisë, Pulmologji, Fiziatriisë (i cili ishte shumë mirë i pajisur me mjete moderne për ushtrime), Psikiatriisë, Stomatologjisë dhe i Farmacisë.
- Respektohen procedurat e rregullta; mjeku e viziton pacientin pa pranin e gardianeve. Kërkesa për vizitë bëhet nëpërmjet teknikëve medicinalë gjatë vizitës së pavijonit.
- Gjatë masave disiplinore parapraakisht e pyesin mjekun për gjendjen shëndetësore dhe pak a shume masa varet edhe nga mjeku. Transporti deri në qendrën mjekësore më të afërt jashtë spitalit bëhet me automjetin e ndihmës së shpejtë.

▪ **Gjetjet**

- Spitali është demtuar mjaftë;
- Ambulantes i pikon tavani;
- Dhoma e teknikeve ka lagështi;
- Dhoma e arhives ka lagështi;
- Pikon tavani edhe në dhomen e shefit mjekësor (nuk e pamë ishte e mbyllur);

- Një hapsirë e arkivit është e pashfrytëzueshme për shkak të lagështisë, në dhomen e shefit të ekipit mjekësor pikon tavani, edhe dhoma e ditës e infermiereve ka lageshti;
- Pastertia nuk është e mjaftueshme dhe është vështirë të mbahet në kushte të tilla të demitimit të objektit;
- Shtroja dhe mbuloja e të semureve ishte e papaster dhe nuk ka ndërrim dhe pastrim periodik të mbulesave;
- Dhomat janë të vogla për katër krevate dhe të sëmurit nuk e ndiejnë veten komod në spital;
- Mungonte vijueshmëria e rregullt e stafit specialistik;
- Mungonte Adrenalina, shumë e rëndësishme për raste emergjente të anafilaksisë; si edhe
- Antishok terapia ishte e pakompletuar, në rutinë e anti - shok terapisë nuk kishte adrenalinë dhe antihistaminik, kishte aminofilinë dhe kortikosteroide;
- Nuk ka trajnime të vazhdueshme për edukimin e vazhdueshëm profesional të stafit mjekësor;
- Shërbimi stomatologjik është jashtë funksionit. Mjeku stomatolog ka dhënë dorëheqje nga puna në këtë spital.

Vizita në kuzhinën e QK në Dubravë:

Vizita në kuzhinë u realizua nga Ekipi A, i cili ka vërejtur këtë gjendje:

- Kryekuzhinieri nuk ishte në vendin e punës (mungonte) dhe Kuzhinieri që ishte prezent për momoetin jepte pershtypjen se nuk ishte i informuar mirë për gjendjen në kuzhinë, ose paraqitej si i tillë;
- Kuzhina kryesore ishte renovuar. Ishte bërë renovimi i pllakave dhe pllafonit, nuk vërehej lagështi në tavan. Por, nuk ishte ndërruar inventari fare dhe renovimi pa ndërrim të mjeteve për punë nuk është i mjaftueshëm dhe vështirësit për përgaditjen e ushqimit mbesin pothuajse të njejta;
- Një pjesë e teknikes nuk punon, është e vjetëruar, nuk kanë librezat sanitare, shumica janë pa uniforma dhe nuk ka makinë për larjen e enëve, është sjellë një nga Smrekovnica por nuk është vënë në funksion ende;
- Depoja e ushqimit është renovuar, ushqimiet ruhen në frigorifer, patatet dhe mollat që ishin në depo ishin gjysmë të kalbura dhe jo të freskëta;
- Ushqimi që ruhej në frigorifer kishte rreth 40-50 % dhjame. Nga ngjyra vërehej se është mish i vjetër. Nuk kishte mish nga kofshet, tërë mishi ishte nga brinjët dhe pjesë të tjera të yndyrshme.
- Ushqimi është më i dobët se më parë për shkak të shtrenjtimit të ushqimit, e kjo ka shkuar në dëm të cilësisë, llojlojshmërisë dhe sasisë së shujtës për të burgosur;

- Kuzhina në objektin e drejtorisë është e improvizuar dhe servon deri në 200 shujta në ditë. Edhe pse, është bërë një renovim, edhe më tej mendojmë se nuk i plotëson kushtet e duhura për një kuzhinë që servon rreth 200 shujta në ditë.

Rekomandimet

➤ Infrastruktura dhe Higjiena

- Ka nevojë të renovimit urgjent të pavijoneve 3 dhe 5 por është e nevojshme edhe për pavijonet 1,7, spital si dhe kompletimi i kuzhinës me pajisje;
- Renovim i përgjithshëm i banjave;
- Sanim i njejeve sanitare;
- Furnizim i rregullt me ujë të ngrohtë;
- Pavijoni i shtatë të rinovohet dhe të sigurohen kushte më të mira për të sëmuret e vendosur.
- Furnizim me shtroja dhe mbuloja si dhe ndërrimet e rregullta për pastrim.

➤ Shëndetësia

- Ofrim adekuat të shërbimeve mjekësore dhe ngritje e cilësisë së këtyre shërbimeve;
- Administrim i duhur i furnizimit me barna;
- Realizim i vizitave të rregullta mjekësore për personat në vetmi;
- Funkcionalizimi i autoambulancës.

Spitali

- Pastërtia në spital të jetë më e madhe;
- Farmacia të furnizohet më mirë me barna;
- Urgjentisht të kompletohet Anti - shok-terapia;
- Të vihet në funksion aparati i troponines;
- Të vendoset kontakti me QKUK-që të programohen vizitat specialistike në këtë qendër dhe ekzaminimet radiologjike-CT, RM etj.;
- Mjeket specialist të vijnë në spital sipas orarit ashtu edhe si paguhen –katër herë në muaj;
- Të sigurohet letër lakmuesi për vërtetimin e sterilizimit;

- Sa më shpejtë të pranohet një mjek Stomatolog dhe të filloj nga puna shërbimi stomatologjik;
- Të kontaktohet sa më shpejtë me Qendrën emergjente në Prishtinë në mënyrë që të trajnohet ekipi mjekësor i spitalit për ndihmë emergjente një të sëmuri.

➤ **Trajtimi**

- Hetimi i rasteve ku dyshohet se ka pasur tejkalim të autorizimeve nga ana e oficerëve;
- Të respektohet rendi shtëpiak gjatë realizimit të vizitave nga ana e familjarëve;
- T’iu mundësohet të burgosurve angazhimi në punë;
- Trajtim i barabartë i të burgosurve sa i përket privilegjeve dhe beneficioneve;
- Kategorizimi dhe sistemimi i të dënuarve të bëhet sipas kriterëve ligjore;
- Ofrim i shërbimeve sociale më të avancuara.

➤ **Ushqimi**

- Të përmirësohet cilësia e ushqimit;
- Shpërndarja e ushqimit të bëhet me orar;
- Të funksionalizohen sallat e ushqimit në pavijone.

Kuzhina

- Në kuadër të renovimit të kuzhinës të përfshihet edhe paisja me mjete për kuzhinë, sepse renovimi vetëm i objektit është gjysma e punës;
- Sa më shpejtë punëtorët e kuzhinës të kontrollohen te mjeku dhe të pajisen me librezë sanitare;
- Të sigurohet ushqim më cilësor, sasia e dhjavit të jetë sa me afër normës, mishi të jetë më i freskët, të ketë më shumë sallata, pemë dhe perime;
- Te largohet llamarina ndarëse e kuzhinës me pjesën ku shërbehet ushqimi.

➤ **Informimi**

- Të respektohet e drejta e të burgosurve për informim në gjuhën amtare apo në gjuhën që e kupton;
- Të sigurohet shtypi (gazeta) për personat e dënuar;
- Të shqyrtohen kërkesat dhe ankesat e të burgosurve dhe brenda afateve ligjore t’u kthehet përgjigje me shkrim.

Takimi përmbyllës me drejtorin e QK në Dubravë

Pjesëmarrës: Shqipe Ibraj - Mala, Faton Morina, (IAP); Alban Muriqi, Fatmire Haliti, Reshat Bajrami (QKRMT); Behxhet Shala (KMDLNJ); Rasim Selmani, drejtor dhe Zyrafete Imeraj zv/drejtoreshë në QK Dubravë.

Në takim me drejtorin dhe zv/drejtoreshen, e QKD, përfaqësues të *Task Force* prezantuan gjetjet kryesore në bazë të fushave si: trajtimi, infrastruktura dhe kushtet materiale, shëndetësia dhe kuzhina - të identifikuar gjatë vizitës nëpër hapësirat përkatëse të monitoruara.

Anëtarët e *Task Force* kërkuan nga menaxhmenti i QKD, që për aspekte të caktuara që lidhen sidomos me infrastrukturën dhe kushtet e banimit në këtë institucion të ndërmerren veprime konkrete sa më shpejt që është e mundur.

Drejtori dhe zv/drejtoresha ritheksuan, vlerësimin e tyre për punën e *Task Force* dhe shprehën gatishmërinë që brenda mundësive të tyre do të ndërmarrin veprime në përmirësimin e kushteve të vendosjes së të dënuarve, duke përfshirë edhe ngritjen e nivelit të trajtimit dhe ofrimit të shërbimeve më të mira për të dënuarit. Ata u shprehën se shqetësimet e ngjashme me ato të ekipit monitorues i ndajnë edhe ata dhe po bëjnë përpjekje për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme në QKD.



Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

Qendra Kosovare për Rehabilitim e të Mbijetuarve nga Tortura

Raporti

nga

**Grupi Punues (*Task Force*) i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës (NPM)
Monitorimi i Qendrës Korrektuese (QK) dhe Qendrës së Paraburgimit në Lipjan (QPL),
më 31 maj 2013**

**Ekipi A: Shqipe Ibraj – Mala, zv/e parë e Avokatit të Popullit dhe
Behxhet Shala, drejtor i KMLDNJ**

**Ekipi B: Arbër Berisha, Këshilltar Ligjor në IAP dhe
Vatra Abrashi, monitoruese e KMDLNJ**

**Ekipi C: Shemsedin Mustafa, Këshilltar Ligjor në IAP dhe
Alban Muriçi, monitorues nga QKRMT**

**Ekipi D: Reshat Bajrami, mjek – monitorues i QKRMT dhe
Fitnete Mala, Këshilltare Ligjore, IAP (kjo ekip ka kryer monitorimin edhe të
QPL)**

Ndërsa Ekipi E, ka monitoruar Qendrën e Paraburgimit Lipjan (QPL)

Takimi me drejtorin e QK në Lipjan:

Task Force fillimisht u takua me drejtorin e Qendrës Korrektuese në Lipjan (QKL), z. Hestet Loku, të cilin e informuan për qëllimin e kësaj vizite. Drejtori Loku e informoi Grupin Punues me gjendjen aktuale në këtë qendër korrektuese, duke theksuar se problemet në këtë qendër janë kryesisht ato që lidhen me mbipopullimin për arsye të numrit të madh të dënuarve për kundërvajtje, çështjet shëndetësore në veçanti furnizimi me barna, mungesa e stafit shëndetësor siç janë psikologu, psikiatri po ashtu edhe mungesë e punëtorëve social. Z. Loku përmendi edhe problemin me stafin (oficeret korrektues) gjatë ndërrimit të natës. Mirëpo, pamundësia për sistemimin në pavijonin O në bazë të natyrës së veprës dhe moshës është e evidente. Po ashtu problem tjetër paraqet edhe centralizimi i financimit i cili ua vështirëson punën në këtë qendër.

Vizita në pavijonin O (Femrat e denuara dhe të paraburgosura):

Vizita e **Ekipit A** në këtë pavijon filloi me një takim të shkurtër me mbikëqyrësen e pavijonit znj. Remzije Luma, e cila u informua me qëllimin e vizitës dhe nga ana e saj u siguruan këto informata të përgjithshme.

Gjithsej 59 të privuar nga liria, ndërsa kapaciteti është 60, prej të cilave 32 janë të dënuara ndërsa 27 të paraburgosura. Prej tyre dy ishin të mitura, një më masë edukative ndërsa një e paraburgosur. Sa i përket strukturës etnike, 3 ishin të komunitetit Rom, 1 Ashkali, si dhe 2 shtetase të Ukrainës, 1 Gjermane dhe 4 nga Shqipëria.

Në pavijon janë të vendosura dy kuti të ankesave dhe shtypi ditor shpërndahe për çdo pavijon nga dy ekzemplar-falas. Kategorizimi në këtë pavijon nuk ekziston dhe nuk është në përputhje me natyrën e veprave dhe kohëzgjatjen e dënimeve, ndërsa angazhimi i të dënuarve në punë ofrohet.

Pas përfundimit të takimit me znj. Luma ekipi vazhdon vizitën nëpër hapësirat e pavijonit ku edhe vëren këtë gjendje:

▪ Infrastruktura

- Numri i personave të vendosura në disa dhoma shkon deri në 6 dhe mbipopullimi është evident. Në disa dhoma është një gjendje e papranueshme (010, 011);
- Në pavijon një nga dhomat e cila është adaptuar (nga dhoma e ditës) për vendosjen e disa femrave nuk ka tualet fare dhe ato janë të detyruara të shfrytëzojnë tualetin e oficerëve;
- Nuk ka dhomë të veçimit për raste të caktuara kur shqiptohen masat disiplinore;
- Nuk janë të ndara të miturat nga të dënuarat e moshës madhore;
- Instalimi i rrjetit elektrik është tejet i vjetër dhe paraqet rrezik për të dënuarat;
- Ka mungesë të theksuar të inventarit nëpër dhoma (karrige, tavolina, sirtarë për rroba);
- Stafit s'kanë hapësirë të duhur për punë dhe mungojnë edhe pajisjet elementare siç janë tavolinë, karrige, kompjuteri, dhe sirtarët për dhomë;
- Për shkak të hapësirës oficerët dhe mbikëqyrësi janë të detyruara të qëndrojnë në një dhomë.

▪ **Higjiena**

- Banjat janë të përbashkëta ndërsa tualetet janë nëpër dhoma dhe janë të hapura, në shumicën e tualeteve ka rrjedhje të ujit;
- Nëpër dhoma dhe korridor ka lagështi dhe mbajtja e pastërtisë është e vështirësuar;
- Furnizimi me ujë të ngrohtë është i kënaqshëm;
- Çarçafët ndërrohen dhe pastrohen çdo 15 ditë, ndërsa rrobat pastrohen në lavatriçe çdo javë;
- Furnizimet me mjete higjienike janë në nivel por cilësia është shumë e dobët.

▪ **Shëndetësia**

- Mungesë e theksuar e vizitave të rregullta mjekësore;

▪ **Trajtimi**

- Sa i përket trajtimit nuk është hasur asnjë ankesë dhe ka pasur fjalë të mira për stafin dhe udhëheqësit e QK.

▪ **Ushqimi**

- Nuk ka ankesa sa i përket përgatitjes dhe ofrimit të ushqimit;
- Të dënuarat kanë të drejtë të furnizohen një herë në muaj me pako ushqimore deri në 5 kg, me gjërat të cilat nuk gjinden në kantinë.

▪ **Informimi**

- Nuk janë sa duhet të informuar me të drejtat e garantuara;

Vizita në pavijonet A,B, C, Shkolla (te miturit):

Ekipi B fillimisht vizitën e kanë filluar në ambientin e shkollës sepse shumica e të miturve me masë edukuese në atë kohë ishin duke vijuar mësimin:

Orari mësimor ishte prej orës 8:00-11:50 shkollimin e vijnë gjithsejtë 17 të mitur prej tyre:12 me mase edukative, 4 te paraburgosur dhe një i dënuar.

Numri i mësimdhënësve të cilët i mbulojnë të gjitha paralelet është 11 për lëndë të ndryshme, gjë që krahasuar me vitin 2012 gjendja është shumë më e mirë sepse kanë qenë vetëm 4 mësimdhënës për të gjitha lëndet.

Në kuadër të shkollës së mesme funksionon drejtimi informatikë, po ashtu në kuadër të shkollës organizohen aktivitete kulturore, grupi i dramës dhe grupi i muzikës.

Biblioteka është e furnizuar mirë me 3400 ekzemplar dhe organizuar shumë mirë. Kjo bibliotekë me libra furnizohet nga donacionet e ndryshme.

Numri i përgjithshëm i të miturve në të gjitha pavijonet ishte 36, prej tyre 12 ishin të dënuar, 16 të mitur me masë edukative dhe 8 të paraburgosur, ku njëri prej tyre me kombësi serbe u lirua në momentin e monitorimit.

Krahasuar me vitin e kaluar kishte një rënie të dukshme të numrit të delikteve nga ana e të miturve, 30-40% gjë që ka ndikuar në uljen e numrit të të miturve në këtë qendër.

Pas përfundimit të vizitës në ambientet e shkollës, ekipi ka vazhduar vizitën nëpër hapësirat e pavijonit ku edhe vëren këtë gjendje:

▪ **Infrastruktura**

- Numri i personave të vendosur në dhoma është nga 3, derisa dhoma është për 6 persona sepse janë 6 shtretër;
- Dhomat ishin të pajisura me sirtar, karrige me tavolinë, TV, ndriçim dhe hapësirë të mjaftueshme;
- Stafit nuk kanë hapësirë të duhur për punë dhe mungojnë edhe pajisjet elementare, siç janë tavolina karrige, kompjuteri, dhe sirtarët për zyre.

▪ **Higjiena**

- Banjat janë të përbashkëta, në shumicën e tualeteve tavani është i mykur nga rrjedhja e ujit, ndërsa pastërtia nuk është në nivel;
- Furnizimi me ujë të ngrohtë është i kënaqshëm dhe të miturit pastrohen 3-4 herë në javë;
- Mbulesat ndërrohen dhe pastrohen çdo 15 ditë, ndërsa rrobat pastrohen në lavanderi çdo javë.
- Furnizimet me mjete higjienike janë në nivel, por cilësia është e dobët.

▪ **Shëndetësia**

- Mungesë e theksuar e vizitave të rregullta mjekësore;

▪ **Trajtimi**

- Sa i përket trajtimit nuk është hasur asnjë ankesë dhe ka pasur fjalë të mira për stafin dhe udhëheqësit e QK.

▪ **Ushqimi**

- Nuk ka ankesa sa i përket përgatitjes dhe ofrimit të ushqimit.
- Të dënuarat kanë të drejtë të furnizohen një herë në muaj me pako ushqimore deri në 5 kg, me gjërat të cilat nuk gjinden në kantinë.

- **Informimi**

- Nuk janë sa duhet të informuar me të drejtat e garantuara.

- **Aktivitetet e jashtme**

- Shëtitjet realizohen 2-3 herë në ditë;
- Aktivitete sportive: futboli, basketboli, fitnesi dhe palestra sportive në kuadër të shkollës.

Pavioni D

Vizita e **Ekipit C**, në këtë pavijon filloi me një takim njoftues me mbikëqyrësin e pavijonit z. Dobrivoje Miletic dhe një oficer korrektues të këtij pavijoni, të cilët u informuan me qëllimin e vizitës dhe nga ana e tyre u siguruan informatat si në vijim:

Gjithsej: të pranishëm 54 persona, ndërsa kapacitetit i përgjithshëm 60. Në këtë pavijon mbahen personat e dënuar, me dënime për kundërvajtje (nga 1 ditë deri në gjashtë muaj).

Pas përfundimit të takimit me udhëheqësit e këtij pavijoni ekipi vazhdoi vizitën nëpër hapësirat e pavijonit me observime gjithë përfshirëse të ambienteve dhe intervistimin e të dënuarve. Gjetjet, vrojtimet dhe konstatimet e ekipit monitorues janë përmbledhur si në vijim, sipas fushave/indikatorëve kryesorë të vlerësimit të respektimit të të drejtave të personave të dënuar:

- **Infrastruktura**

- Objekti është rinovuar në vitin 2012;
- Dhomat kanë nga katër shtretër, kanë TV (mund t'i sjellin të dënuarit), tavolinë me karrige të fiksuara. Mungon inventari (dollapët) për vendosjen e rrobave dhe gjësendeve personale. Tualetet janë të vendosura përbrenda dhomave. Ajrosja dhe ndriçimi janë të mjaftueshme;
- Hapësira nëpër dhoma, është e pakët. (dhomat e vogla për katër persona të vendosur);
- Të dënuarit ankohen se janë tepër të mbyllur nëpër dhoma (dhomat mbyllen 4-5 herë në ditë);

- **Higjiena**

- Banjat janë të përbashkëta dhe në gjendje të pranueshme higjienike. Tualetet brenda dhomave dhe në nivel të duhur higjienik;
- Dhomat dhe ambientet tjera mirëmbahen mirë;
- Të dënuarit ankohen për mungesë peshqirësh me rastin e pranimit në Institucion;
- Çarçafë nuk ka për të gjithë;
- Të dënuarit kanë qasje në banjë çdo ditë, por nuk ka ujë të ngrohtë rregullisht.

▪ **Shëndetësia**

- Ankesa për shërbime të dobëta shëndetësore (vonesa dhe mungesë trajtimi; mungesë medikamentesh);
- Stafit ankohet për vështirësitë që ju sjell fakti se brenda pavijonit ka disa të sëmurë si dhe përdorues të drogës, dhe nuk ka shërbime të duhura për ta;
- Brenda stafit ka anëtarë të moshuar me sëmundje të rënda kronike fizike.

▪ **Trajtimi**

- Të dënuarit nuk kanë ankesa për keqtrajtim apo shkelje të të drejtave të tyre;
- Kontakti me jashtë realizohet përmes vizitave të familjarëve/miqve, pranimit të vizitave si dhe komunikimit me telefon. Të dënuarit ankohen se nuk ju mjaftojnë kartelat telefonike vetëm një herë në javë - përmes vizitave familjare;
- Ka mjaft ankesa në punën e Komisionit për Lirim me Kusht. Shumë kërkesa/raste presin me kohë të gjatë për shqyrtim si dhe vonohen përgjigjet.

▪ **Raportet e ndërsjella**

- Të dënuarit pohojnë se kanë raporte të mira më stafin korrektues, stafin mbikëqyrës, Drejtorin e institucionit po edhe ndërmjet vete;
- Safi mbikëqyrës sikurse ai korrektues ankohet për mungesë të stafit natën përderisa rutina ditore janë mjaft intensive. Në ndërrim nate psh. shërben vetëm një anëtarë stafi i cili duhet të përkujdeset për një numër prej afro 60 të dënuarve.

▪ **Ushqimi**

- Nuk ka ankesa për cilësinë e ushqimit dhe kohën e shërbimit;
- Të dënuarit ankohen për mënyrën e servimit të ushqimit nëpër dhoma në kushtet e hapësirës së ngushtë nëpër dhoma si dhe për arsye higjienike;
- Ankesa për qasje të rrallë në kantinë- një herë në javë.

▪ **Informimi**

- Të dënuarit ankohen se nuk i dinë të drejtat e tyre si persona të dënuar. Nuk ka ndonjë shkresë apo informacion në dhomat e tyre, derisa ka një fletë informacion në dyert e secilës dhomë mbi rendin shtëpiak/rutinën ditore.

▪ **Aktivitetet e jashtme**

- Shëtitjet realizohen dy herë në ditë nga 45 minuta;

- Aktivitetet sportive vetëm njëherë në javë nga 45 minuta. Ka kërkesa për më shumë aktivitete sportive.

Vizita në Spitalin e Lipjanit

Stafi përbëhet nga: gjashtë teknik, katër mjeke, një mjeke dermatovenerologe - përgjegjëse e ambulantes - Dr.Imrane Konjufca dhe një mjeke e praktikës se përgjithshme - Hamnije Rexha.

Një mjek psikiatër-Dr. Arif Jahiu, një herë në javë dhe në thirrje, një gjinekologe Dr. Hana Qafdarbasha me orar pune dy herë në javë.

Në këtë qendër korrektuese është edhe ambulanca stomatologjike, stomatologia- Dr. Luljeta Zaimi punon tri herë në javë nga katër ore.

Dhoma e gjinekologjisë është e rregulluar mirë por aparati i vjetër i ultrazërit nuk është rregulluar, ndërsa një aparat portabel nuk i plotëson nevojat.

Tani është në punë edhe stacionari, i cili shërben për pranimin e personave të operuar apo atyre me sëmundje ngjitëse. Për momentin ishte e shtrire një paciente me sëmundje kronike – A. R. me Dg; Adenocarcinoma infiltrativa duodeni. Pacientja ishte e kënaqur me tretman. Stacionari ka dy dhoma me nga tre shtretër por të dy dhomat e kanë një hyrje. Në rast se një pacient ka sëmundje ngjitëse atëherë nuk ka siguri edhe për të tjerët, sepse nuk mundë të jenë të izoluar, kanë një hyrje të përbashkët;

Gypat përcjellës të kanalizimit me gjasë nuk janë shumë funksional;

Sot ushqimi ishte me kualitativ se herëve të tjera;

Numri i pacientëve të vizituar për tre muajt e parë ishte 318 vizita.

Nga ato:

Vizita tek neuropsikiatri kanë qenë 21 raste;

Vizita tek gjinekologjia kanë qenë 3 raste;

Vizita tek stomatologu kanë qenë 53 raste.

Protokollet

Protokolli i abuzimit me substanca narkotike 2 raste

Protokolli i grevës se urisë	0 raste
Protokolli i tentim suicidit	0 raste
Protokolli i abuzimeve seksuale	0 raste
Protokolli i vetëlëndimeve	1 raste
Protokolli i vdekjeve	0 raste
Protokolli i lëndimeve	2 raste(janë përshkruar si lëndime ne sport)

Përshkrimi i një flete të protokollit të lëndimit

Nr.	Data	Emri dhe Mbiemri	Datëlindja	Vendi i lindjes	Vendbanimi	Përshkrimi rastit

Aparatura

Laboratori tani nuk punon, sepse mungon laboranti. Analizat laboratorike mund të bëhen vetëm jashtë këtij institucioni.

Në ambulancën e gjinekologjisë punohet me një aparat të vogël-aparat portabel. Nuk e kemi takuar gjinekologen dhe nuk e dimë se sa i plotëson nevojat një aparat i tillë, ndërsa ultrazëri i vjetër ende është jo funksional.

Barnat

Sipas kryeinfermieres Znj. Nergjivane Olluri, tani janë të furnizuar mirë me barna. Gjatë monitorimit tonë nuk vërejtëm se mungonte ndonjë ilaç.

Ambulanca stomatologjike

Ne ambulancën stomatologjike puna është vështirësuar shumë për arsye se karrigia stomatologjike është në defekt. Në këtë ambulancë mund të bëhen vetëm nxjerrje të dhëmbit, ndërsa punët tjera stomatologjike janë të lidhura ngushtë me kërrigën stomatologjike dhe pa u riparuar defekti nuk mund të fillohet puna.

Kuzhina

Shef i kuzhinës Z. Zijadin Berbatovci, njofton Ekipin se: në kuzhinë punojnë 6 kuzhinier civil (katër meshkuj dhe dy femra) dhe 8 punëtore, të dënuara.

Shumica e elementeve punojnë, me përjashtim te enëlarëses e cila edhe pse është, ajo në realitet nuk punon asnjëherë;

Mostrat e ushqimit nuk ruheshin;

Librezat sanitare mungonin;

Kuzhina ka sallën e ngrënies, e cila është mirëmbajtur mjaft mirë. Kjo sallë përdoret edhe për aktivitete kulturore, drama, koncerte etj.;

Nuk kishte defekte të makinerisë. Gjatë monitorimit tonë u vërejt se ndihet ende era në kuzhinë, por me pak se herëve të tjera;

Në këtë Qendër Korrektuese bukën e përgatitin punëtorët civil me ndihmën e personave të dënuar;

Në këtë furrë punon një punëtore me pagese dhe tri të burgosura që i ndihmojnë gjatë punës udhëheqëses së tyre;

Për momentin për shkak të defekteve me rrymë elektrike furra nuk punonte, dhe buka blihej në qytet;

Furra gjatë ditës nxjerr deri 150 bukë për Qendrën korrektuese për të mitur dhe femra dhe 250 bukë për qendrën e paraburgimit ne Lipjan;

Ka mikserin për përgatitjen e brumit, komoren për ardhjen e bukës, dhe furrën (shporetin) për pjekje;

Të gjitha pajisjet janë funksionale;

Edhe pastërtia është në nivel;

Nuk kemi gjetur parregullsi

Gjetjet

1. Nuk punon Laboratori;
2. Nuk punon stomatologu me tërë kapacitetet, për shkak të defektit të karriges stomatologjike;
3. Mungojnë test trakët për kontrollimin e sterilizatorit;
4. Nuk punon makina për larjen e enëve;
5. Vjen erë në banja e kuzhinë dhe rreth saj për shkak të kanalizimit jo shumë funksional.

Rekomandimet për:

Spitali

- Të punësohet një laborant dhe të futet në punë përsëri laboratori;
- Të rregullohet sa më shpejtë karrigia stomatologjike;
- Të kontrollohet sterilizimi, sepse ka rëndësi shumë të madhe për pacientet;

Kuzhina

- Të rregullohet sa më parë enëlarësja;
- Të rregullohet kanalizimi në kuzhinë;
- Sa më parë të rregullohen librezat sanitare.

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

- Renovim i përgjithshëm i pavijonit O, sidomos i banjave dhe dhomave O10, O11, të cilat janë te pabanueshme;
- Pajisja me inventar te nevojshëm;
- Krijimi i hapësirave për punë të mjaftueshme të stafit – zgjerimi i hapësirës dhe kompletimi me pajisje sidomos me kompjuter;
- Krijimi i kushteve për vizita te lira për te dënuarat (sigurimi i një dhome te veçantë)
- Krijimi i hapësirës së ndarë për te mitura, ndaras nga të dënuarat e rritura;
- Krijimi i hapësirës për mbajtjen e te dënuarave me masë disiplinore;
- Njoftimi me kohë për vendimin e panelit për lirim me kusht;
- Koordinim më i mirë i punës në mes të gjykatës dhe qendrës sociale me stafin e shërbimit korrektues ne Lipjan;
- Sigurimi i kushteve për mbulim shëndetësor për 24 ore si dhe shtimi i numrit te stafit (psikolog, psikiatër dhe punëtor social me ora te plote te punës);
- Sigurimi i numrit te mjaftueshëm te stafit korrektues veçmas atij në ndërrimin e natës;
- Funkcionalizimi i sallës kolektive e ushqimit në pavijonin D për të dënuarit – kundërvajtës;

- Të sigurohen çarçaf të mjaftueshëm për të dënuarit në Pavijonin D, sikurse edhe peshqir me rastin e pranimit të tyre në institucion;
- Të sigurohet ujë i ngrohtë mjaftueshëm për të dënuarit kundërvajtës;
- Të gjendet zgjidhje për vendosje dhe trajtim adekuat për një numër të konsiderueshëm të të dënuarve për kundërvajtje-përdorues të drogës;
- Të dënuarve për kundërvajtje t'ju ofrohet informacion për te drejtat e tyre si persona të dënuar (vendosja e fletë informacioneve, në mur, dyer etj);
- Të ofrohen më shumë aktivitete të jashtme (sport) për kundërvajtësit;
- Të rishikohen politikat e përgjithshme për regjimin e vendosjes dhe trajtimit për personat e dënuar për kundërvajtje në nivel të Ministrisë dhe Shërbimit Korrektues;

QENDRA E PARABURGIMIT NË LIPJAN

Monitorimi është realizuar nga :

Ekipi E:

Faton Morina, Këshilltar i Lartë Ligjor në IAP

Niman Hajdari, Këshilltar Ligjor në IAP

Fatmire Haliti, Monitoruese në QKRMT

Tringa Shehu, Monitoruese në KMLDNJ dhe

Jerina Dampier, Këshilltare Speciale në IAP

Ekipi D:

Reshat Bajrami, mjek/monitorues në QKRMT

Fitnete Mala, Këshilltare Ligjore në IAP

Task Force fillimisht është takuar me drejtorin e QPL, z. Arif Beqaj, nga i cili janë informuar se:

Kapaciteti i Institucionit: 170

Gjendja aktuale: 174 (162 të paraburgosur; dhe 12 të dënuar)

Shtetas të huaj: 13 (hungarezë, rumun, turq, shtetas të Shqipërisë)

Numri i stafit: 154 (prej tyre 131 janë staf i uniformuar; dhe 21 janë staf civil)

Në përgjithësi për institucionin

Kjo Qendër Paraburgimi është ndërtuar në vitin 2003, dhe është e dedikuar për të paraburgosurit, mirëpo në të janë të vendosur edhe të dënuar. Të gjitha të dënuarit dhe 10 të paraburgosurve janë të angazhuar në punë (kuzhinë, pastrim, kopsht). Drejtori na njoftoi se qendra ka plan qe brenda këtij viti banjat të pajisen me nxehje solare dhe kjo do të përmirëson gjendjen.

Në këtë institucion aktualisht është i vendosur një i paraburgosur me kategori: Rrezikshmëri e Lartë.

Në mesin e të dënuarve, ka të dënuar me burgim të gjatë, si: 18 vjet burgim, 10 vjet burgim etj.

Vizita është realizuar në krahun A, B, C dhe D: të cilët pas përfundimit të takimit me drejtorin dhe informimit për qëllimin e monitorimit, ekipi ka vazhduar vizitën nëpër hapësirat e Qendrës, ku edhe vëren këtë gjendje:

▪ **Infrastruktura**

Infrastruktura e përgjithshme është e dobët, ka lagështi gati në të gjitha dhomat. Kishin vendosur kova në plafon për të ndalur pikjen e ujit në dysheme;

Kjo qendër ka kapacitet për 170 të para/burgosur, ndërsa prezent janë 174 të para/burgosur. Për shkak të numrit të madh të para/burgosurve dhe mungesës së vendeve të lira, disa nga të paraburgosurit është dashur të vendosën, me dyshekë në dysheme. Vendosja e të paraburgosurve në dyshekë paraqet kufizim të të drejtave të paraburgosurve, si të atyre që janë të vendosur në dyshekë e po ashtu edhe të atyre që janë të vendosur në shtretër për shkak se iu është kufizuar hapësira dhe shumicën e kohës duhet të qëndrojnë në shtretërit e tyre.

Në dhomat e të para/burgosurve janë të vendosura nga një tavolinë me dy karriqa – statike, përderisa në secilën dhomë ishin të vendosur nga 3 apo nga 4 të para/burgosur. Për këtë arsye gjatë kohës së ushqimit disa nga të para/burgosur duhet të ulen në tokë për të ngrënë ushqimin.

Ventilimi: ventilimi nuk punon në asnjërën prej dhomave, ndërsa, në disa nga tualetet e dhomave, ishte funksional.

Shtroja dhe mbuloja: shtrojë dhe mbulojë (çarçafë, batanije, jastëk) kishte në të gjitha dhomat. Edhe pse pastrimi i çarçafëve sipas rregullores duhet pastruar çdo javë, ato pastrohen çdo 10 ditë apo çdo 2 javë. Ndërsa kishte ankesa për mospastrimin e batanijeve, njëri nga të paraburgosurit e intervistuar, deklaroi se ka 14 muaj që është në paraburgim dhe asnjëherë nuk iu është pastruar batanija.

Disa dhoma janë jashtë funksionit edhe pse për disa sanime të vogla teknike.

Salla e fitnesit ishte mbyllur dhe kishte ankesa lidhur me këtë.

▪ **Higjiena**

Banjat: përkundër faktit që në fund të vitit 2012 janë rinovuar banjat në pavijonin B, ato ishin jashtë funksionit, për shkak të bojlerëve që ishin në defekt. Sipas rregullores është paraparë që çdo dy ditë të pastrohen, mirëpo pastrimi bëhet më rrallë – çdo të 4-ten ditë apo edhe më rrallë në mungesë të ujit në ngrohtë. Të para/burgosurit e këtij pavijoni dërgohen për t'u pastruar në pavijonin A apo në C dhe D, dhe si pasojë e dërgimit për pastrim në pavijonet tjera, shpesh herë mbetën pa u pastruar për shkak se nuk ka ujë të ngrohtë të mjaftueshëm.

Nga intervistat e të paraburgosurve, ata deklarohen se institucioni nuk iu shpërndan produkte higjienike (shampon, sapun, bica etj.). Ato i sigurojnë përmes kantinës, përveç rasteve që nuk kanë mundësi financiare të cilëve ia siguron institucioni. – Drejtori përgjigjet se nuk kanë produkte higjienike me i shpërndarë të gjithëve, përveç atyre që bëjnë kërkesë.

▪ **Shëndetësia**

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore - Të para/burgosurit në të gjitha dhomat e vizituara, kanë shprehur ankesa në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe stomatologjike.

Po ashtu, kishte ankesa edhe sa i përket shpërndarjes së terapisë, njëri nga të intervistuarit tregon se një ditë iu është ofruar një tabletë përmes oficerit të krahut i cili ia ka sjellë në dorë. Apo, se kryesisht ofrohet paracetamol pa marrë parasysh dhimbjen që kanë.

Punëtori social deklaron, se i ka kontaktuar vetëm kur janë pranuar në institucion dhe më nuk i ka vizituar, përjashtim më ndonjë rast që ka kërkuar vet për tu takuar me punëtorin social.

▪ **Trajtimi**

Nuk ka pasur pohime për keqtrajtim apo rrahje. Megjithatë, kishte ankesa në disa prej anëtarëve të stafit, për të cilët pohojnë se nganjëherë nuk kanë trajtim të barabartë për të gjithë të paraburgosurit, p.sh shkurtimin e shëtitjes; mos dërgimi në pastrim sipas rregullit.

▪ **Ushqimi**

Nga intervistat me të para/burgosurit, ata shprehën se janë të kënaqur me cilësinë e ushqimit në krahasim me vitin e kaluar – ushqimi i drekës. Ata shprehin pakënaqësi me ushqimin që iu shërbehet në mëngjes dhe në darkë, siç janë konservat, rriskë gjedhi dhe pashtetat të cilat vijnë të hapura për shkaqe sigurie dhe i mungon data e prodhimit dhe kalimit të afatit, e po ashtu iu mungon edhe mbështjellësi me përbërjen e produktit.

▪ **Informimi**

Të para/burgosurit e intervistuar kanë deklaruar se nuk janë të njoftuar me të drejtat e tyre që iu takojnë. Në dhomat e tyre ishin vendosur në derë njoftimet me rendin shtëpiak dhe reagimin në rast zjarri, por jo edhe për të drejtat e të para/burgosurve.

TV dhe gazetat: në të gjitha dhomat kishte TV me 4 programe, ndërsa gazeta nuk iu shpërndahet. Po ashtu përkundër që gazeta nuk iu shpërndahet, nuk iu mundësohet që ta

sigurojnë furnizimin me rregull me pagesë (çdo ditë), por vetëm gjatë vizitave nga familja mund të marrin nga 2 gazeta.

Biblioteka ka mungesë të librave dhe shumica e atyre janë te vjetra dhe te dëmtuara.

Paraburgimi: Kishte të paraburgosur me paraburgim afatgjatë, prej mbi 5 vitesh, 3 vitesh, 2 vitesh. Po ashtu pati ankesa ndaj avokatëve, për mos interesim të ofrimit të shërbimeve dhe kryerjes së detyrës, në ofrimin e mbrojtjes adekuate.

Ambulanca

Ekipi D, është njoftuar se : Ambulanca është rinovuar, mirëpo, në të vërtetë ajo vetëm ishte gëlqerosur dhe asgjë me tepër.

Stafi, përbëhet nga 6 punëtorë shëndetësorë: një mjek – Dr. Bedri Sadriu specialist i mjekësisë familjare-përgjegjës i ekipit dhe gjashtë teknik medicinal;

Mjeku psikiatër-Dr.Arif Jahiu, punon njëherë ne jave;

Shërbimi mjekësor është në dispozicion 24h,-një teknik mban kujdestarin, ndërsa mjeku është me orar të shkurtuar dhe përgjigjet në thirrje 24 orë;

Në rast nevoje transporti deri te spitali më i afërt bëhet me veturë të policisë e në raste nevoje edhe me ndihmë të shpejtë.

Nga pajisjet mjekësore kanë:

EKG, Sterilizator, stetoskop, tensiometër, oftalmoskop, otoskop, setin kirurgjik dhe një puls oksimetër;

Gjate muajit prill në këtë ambulancë ka pasur gjithsejtë 177 vizita mjekësore;

Prej tyre, 61 vizita kanë qenë psikiatrike;

Ndërsa, 45 vizita kane kërkuar ndihmën e stomatologut;

Psikologun kanë vizituar 25 raste.

Barnatorja mbahej mirë, nuk janë gjetur barna të dala nga afati. Mirëpo, kishte mungesa të barnave. Mungonin: Adrenalina, Paracetamolli, Metoprololi, Amoxilli, Nitroglicerina, Heparina e shumë barna te tjera.

Seti për antishok terapi nuk ishte i kompletuar - mungonte adrenalina.

Kuzhina

Stafi i kuzhinës, përbëhej nga: shefi i kuzhinës z. Avdush Krasniqi, katër punëtorë civil dhe gjashtë punëtorë të dënuar.

Në kuzhinë punonin të gjitha mjetet e kuzhinës me përjashtim të makinës për larjen e enëve e cila nuk funksionon me vite (ne realitet nuk ka pasur asnjëherë makinë adekuate për larjen e enëve) . Është siguruar ujë i ngrohtë me anë të një bojleri prej 1000 litrash. Pastërtia relativisht e mirë.

Ushqimi kalorik, menyuja e njëjtë, ngjashëm me herët e tjera, jo e larmishme. Buka tani prehet në pjesë të vogla dhe nuk shkon dëm.

Sot për drekë kishte supë, mish gjedhi, sallat të gjelbër dhe një lëngë. Punëtorët ishin të pastër dhe me uniforma laramane, dikush kishte të sipërmen dikush të poshtmen, (d.m.th. nuk janë te informuar mire).

Mostrat e ushqimit ruheshin.

Asnjë kuzhinier nuk kishte libreza sanitare.

Gjetjet

1. Në ambulante vërehen gjurmë të lagështisë dhe dëmtimit (tavani i njëres dhomë);
2. Nuk ka staf të mjaftueshëm, një teknik e ka lëshuar punën, dy motra janë në pushim lehonie;
3. Mungonin shumë barna : analgetik, antiaritmik, antibiotik antikuagolant etj.;
4. Sterilizatori nuk ishte kontrolluar asnjëherë, nuk kishin indikator për sterilizim;
5. Nuk mbahej fletore për evidentimin e sterilizimit;
6. Nuk ishte komplet kutia e anti shok terapisë - nuk kishte adrenaline;
7. Nuk punon EKG-ja;
8. Nuk punon Otokopi;
9. Nuk punon Oftalmoskopi;
10. Nuk funksionon mirë Sterilizatori;
11. Në kuzhine vjen erë e keqe, për shkak të kanalizimit jo funksional;
12. Në kuzhinë mungon sapuni për larjen e duarve;
13. Librezat sanitare mungojnë;
14. Nuk ka makinë për larjen e enëve

Rekomandimet për:

Ambulanca

- Të sigurohen urgjent barnat që mungojnë;
- Të kompletohet seti për anti - shok terapi;
- Të rregullohet urgjent aparati i EKG-së;
- Të rregullohen oftalmoskopi dhe otoskopi;
- Të kontrollohet puna e sterilizatorit me indikator për kontrollë;

Kuzhina

- Të sigurohet një makinë për larjen e enëve;
- Të rregullohet kanalizimi në kuzhinë;
- Punëtorët e kuzhinës të pajisen me libreta sanitare;
- Të rinovohet ambulanta

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

- Të rinovohen dhomat që janë jashtë funksionit;
- Të evitohet lagështia në dhoma dhe korridore;
- Të rregullohen nyjet sanitare;
- Të sigurohen kushte të dinjitetshme për vendosje dhe mbajtje (urgjentisht të evitohet vendosja e tyre në dyshek);
- Të sigurohen karrige për qëndrim ditor për të gjithë të paraburgosurit;
- Të funksionalizohet ventilimi në të gjitha dhomat;
- Të vihen në funksion banja e pavijonit B;
- Të sigurohet uji i mjaftueshëm, i ngrohtë për të gjithë;
- Të pastrohen me rregull shtrojat dhe mbulojat (një herë në javë sipas rregullores);
- Të pastrohen batanijet;
- Të furnizohen të paraburgosurit me produkte higjienike;
- Ushqimet e konservuara të hapen në prani të të paraburgosurve;
- T'ju sigurohet shtypi ditor me rregull;
- Te furnizohet biblioteka me libra të mjaftueshëm;
- Të rihapet salla e fitnesit;